



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË

VENDIM

Nr. 04 Datë 24 . 01 .2025

“Për shprehjen në parim për miratimin e hartës së përgjithshme të stacioneve të plazheve të lejuara dhe përcaktimi i vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në zonën e plazhit, për sezonin turistik 2025”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja “c”, nenit 18 pika 2, nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55 pika 4, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 649, datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të VKM-së nr. 845, datë 28.10.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”, VKM-së nr. 321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në dete e plazhe, në ujrat e brendshme në thellësi të territorit gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, Këshilli i Bashkisë Kavajë në mbledhjen e tij të rradhës:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të hartës së përgjithshme të stacioneve të plazheve të lejuara si dhe përcaktimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në zonën e plazhit, për sezonin turistik 2025.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kadastres Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative, Drejtoria e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij projekt-vendimi.
3. Një kopje e vendimit ti dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare (Drejtorisë së Policisë Kufitare Durrës) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Agjencisë Kombëtare të Bregdetit)
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

KRYETAR
RUDIN HYLVIU

Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota 25
Vota Pro 24
Vota Kunder -
Vota Abstenim 1
Zbardhur me datë 24/01/2025

